



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

KOMISIONI I PROVIMEVE TË AFTËSIVE PROFESIONALE

23.12.2020

Zbatimi në praktikë i kërkesave të legjislacionit të tatimeve dhe taksave në Republikën e Shqipërisë

TEZA 5

ALTERNATIVA (10 x 1 pikë)

1. Cila nga alternativat e mëposhtme është e vërtetë në lidhje me mallrat që përjashtohen nga detyrimet e importit;

- a) Mallrat e blera nëpërmjet porosisë nga interneti, që importohen nëpërmjet dërgesave postare, vlera e të cilave nuk e kalon vlerën ekuivalente në lekë të shumës 22 euro;
- b) Mallrat e blera nëpërmjet porosisë nga interneti, që importohen nëpërmjet dërgesave postare, vlera e të cilave nuk e kalon vlerën ekuivalente në lekë të shumës 32 euro;
- c) Dërgesat e mallrave nga një individ jashtë Republikës së Shqipërisë për një individ në Republikën e Shqipërisë, të një natyre rastësore, pa pagesë dhe që përmbajnë vetëm mallrat e destinuar për përdorim personal ose familjar prej marrësit, vlera e të cilave nuk e kalon vlerën ekuivalente në lekë të shumës 45 euro;
- d) Dërgesat e mallrave nga një individ jashtë Republikës së Shqipërisë për një individ në Republikën e Shqipërisë, të një natyre rastësore, pa pagesë dhe që përmbajnë vetëm mallrat e destinuar për përdorim personal ose familjar prej marrësit, vlera e të cilave nuk e kalon vlerën ekuivalente në lekë të shumës 55 euro;
- e) Mallrat e blera nëpërmjet porosisë nga interneti, që importohen nëpërmjet dërgesave postare, vlera e të cilave nuk e kalon vlerën ekuivalente në lekë të shumës 20 euro;
- f) Alternativat a) dhe b)
- g) Alternativat a) dhe c)
- h) Alternativat b) dhe d)

Përgjigja e saktë është alternativa G

2. Tatimpaguesi, në deklaratën vjetore të të ardhurave, nuk jep të dhëna për të ardhurat bruto, për:

- a) shuma bruto të fituara nga lotari apo lojëra të tjera të fatit;
- b) të ardhurat bruto nga pasuria intelektuale, licencat, të drejtat ekskluzive dhe pasuri të tjera, që përbëhen vetëm nga të drejta dhe që nuk kanë formë fizike;
- c) të ardhura bruto të realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
- d) asnjëra;
- e) a dhe b;
- f) a dhe c;
- g) b dhe c;
- h) a, b dhe c.

Përgjigja e saktë është alternativa D

3. Cila nga alternativat konsiderohet furnizime shërbimi:

- a) kalimi i një pasurie të patrupëzuar, pavarësisht nëse përfaqësohet ose jo me titull pronësie;
- b) operacionet e ndërtimit , kryerja e procesit të ndërtimit, si dhe të mirëmbajtjes;
- c) detyrimi për të mos kryer një veprim apo për mos të lejuar/toleruar një veprim apo një situatë;
- d) kryerja shërbimeve në zbatim të një urdhri të dhënë nga/ose në emër të një autoriteti publik apo në zbatim të ligjit;
- e) të gjitha alternativat më sipër;
- f) a dhe b;
- g) c dhe d;
- h) a, b dhe c.

Përgjigja e saktë është alternativa E

4. Njoftimi për kontrollin tatimor mund të mos përmbajë:

- a) Bazën ligjore për kryerjen e kontrollit;
- b) Analizën e riskut që e kualifikon tatimpaguesin për kontroll tatimor;
- c) Llojin e tatimit, objekt të kontrollit;
- d) Të drejtën e ankimit të tatimpaguesit për vlerësimin rezultues nga kontrolli;
- e) Periudhat tatimore subjekt i kontrollit;
- f) Numrin identifikues të tatimpaguesit
- g) Nënshkrimin e përfaqësuesit të administratës tatimore që inicijon kontrollin tatimor;
- h) Gjithë të mësipërmet janë pjesë e shkresës njoftuese.

Përgjigja e saktë është alternativa B

5. Cila nga alternativat e mëposhtme është e vërtetë në lidhje me dorëzimin e deklaratës vjetore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin?

- a) Deklarata duhet dorëzuar brenda datës 10 janar të vitit pasardhës;
- b) Deklarata duhet dorëzuar brenda datës 10 shkurt të vitit pasardhës;
- c) Deklarata duhet dorëzuar brenda datës 10 mars të vitit pasardhës;
- d) Deklarata duhet dorëzuar brenda datës 20 prill të vitit pasardhës;
- e) Nuk dorëzohet nëse biznesi i vogël rezulton me humbje;
- f) Nuk duhet të deklarohet më duke filluar nga 1 janar 2021, pasi norma e tatimit të thjeshtuar do jetë 0%;
- g) Data e dorëzimit të deklaratës përcaktohet me vendim të këshillit bashkiak vendor;
- h) Asnjëra.

Përgjigja e saktë është alternativa B

6. Cila nga alternativat konsiderohet furnizime shërbimi:

- a) kalimi i një pasurie të patrupëzuar, pavarësisht nëse përfaqësohet ose jo me titull pronësie;
- b) operacionet e ndërtimit , kryerja e procesit të ndërtimit, si dhe të mirëmbajtjes;
- c) detyrimi për të mos kryer një veprim apo për mos të lejuar/toleruar një veprim apo një situatë;
- d) kryerja shërbimeve në zbatim të një urdhri të dhënë nga/ose në emër të një autoriteti publik apo në zbatim të ligjit;
- e) të gjitha alternativat më sipër;
- f) a dhe b;
- g) c dhe d;
- h) a, b dhe c.

Përgjigja e saktë është alternativa E

7. Personi që zgjedh të jetë i regjistruar për TVSH-në, detyrohet të qëndrojë dhe t'i nënshtrohet regjimit normal të TVSH-së:

- a) jo më pak se tre muaj kalendarik;
- b) jo më pak se gjashtë muaj kalendarik;
- c) jo më pak se një vit kalendarik;
- d) jo më pak se dy vite kalendarik;
- e) jo më pak se tre vite kalendarik;
- f) jo më pak se katër vite kalendarik;
- g) Nuk ka një periudhë detyruese ;
- h) Asnjë nga alternativat.

Përgjigja e saktë është alternativa D

8. Cila nga alternativat e mëposhtme është e gabuar:

Tatimpaguesi, në deklaratën vjetore të të ardhurave, jep të dhëna për të ardhurat bruto, në të cilat përfshihen:

- a) të ardhurat bruto nga dividendi për pjesëmarrje në shoqëri tregtare apo nga veprimtaritë e biznesit;
- b) fitimi kapital neto, i krijuar nga investimet në tituj apo në pasuri të paluajtshme;
- c) shpërblimet e marra në rast sëmundje e fatkeqësish;
- d) shuma bruto të fituara nga lotari apo lojëra të tjera të fatit;
- e) a dhe b;
- f) a dhe c;
- g) a dhe d;
- h) c dhe d.

Përgjigja e saktë është alternativa C

9. Nëse kompania audituese certifikon deklarata të pasakta tatimore të tatimpaguesit, atëherë menjëherë:

- a) Tatimpaguesi dënohet me gjobë në masën 50% të diferencës midis shumës që duhej paguar dhe asaj që është paguar në fakt;
- b) Tatimpaguesi dënohet me gjobë në masën 100% të diferencës midis shumës që duhej paguar dhe asaj që është paguar në fakt;
- c) Kompania certifikuese dënohet me gjobë në masën 50% të diferencës midis shumës që duhej paguar dhe asaj që është paguar në fakt;
- d) Kompania certifikuese dënohet me gjobë në masën 100% të diferencës midis shumës që duhej paguar dhe asaj që është paguar në fakt;
- e) Tatimpaguesi kallëzohet penalisht nga administrata tatimore;
- f) Kompania certifikuese kallëzohet penalisht nga administrata tatimore;
- g) Pohimet (b) dhe (c) janë të saktë;
- h) Pohimet (a) dhe (d) janë të saktë.

Përgjigja e saktë është alternativa G

10. Nëse një punëmarrës mungon për 14 ditë pune duke paraqitur raport mjekësor, atëherë ai/ajo përfiton nga ISSH pagën për:

- a) 0 ditë;
- b) 10 ditë pune;
- c) 14 ditë pune;
- d) 10 ditë kalendarike;
- e) 14 ditë kalendarike;
- f) 4 ditë pune;
- g) 6 ditë kalendarike;
- h) Informacion i pamjaftueshëm.

Përgjigja e saktë është alternativa F

PYETJE ME SHITJELLIM

1. Jepni kuptimin e rregjimit të magazinimit doganor dhe cilat janë kushtet kryesore që duhet të plotësojnë subjektet që kërkojnë autorizimit përkatës nga autoriteti doganor? **(2 pikë)**

Përgjigje:

Regjimi i magazinimit doganor lejon ruajtjen në një magazinë doganore: të mallrave jo shqiptare, pa iu nënshtruar detyrimeve të importit ose masave të politikës tregtare; dhe të mallrave shqiptare, kur dispozitat në fuqi që rregullojnë fusha të veçanta, parashikojnë që vendosja e tyre në magazinat doganore kërkon zbatimin e masave që normalisht lidhen me eksportin e këtyre mallrave.

Përdorimi i këtij regjimi mundësohet nëpërmjet lëshimit të autorizimit përkatës nga autoriteti doganor kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

- a) për personat që ofrojnë të gjitha garancitë e nevojshme për kryerjen si duhet të operacioneve;
- b) kur autoritetet doganore mund të mbikëqyrin e kontrollojnë regjimin.

Aplikimi për të përfituar regjimin e magazinimit doganor bëhet pranë degës doganore mbikqyrëse. Autorizimi për regjimin doganor i lëshuar nga autoritetet doganore kompetente përcakton kushtet në të cilat zbatohet regjimi përkatës. Mbajtësi i autorizimit duhet të njoftojë autoritetet doganore për të gjithë faktorët që lindin pas dhënies së autorizimit dhe që mund të ndikojnë në vazhdimësinë ose në përmbajtjen e tij.

2. Cilat subjekte përjashtohen nga taksa mbi ndërtesën e parashikuar në ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar ? (2 pikë)

Përgjigje:

Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:

- a) pronat e shtetit dhe të njëjstëve të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- ç) banesat sociale në pronësi të bashkive;
- d) pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
- dh) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- e) strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name”;
- ë) ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të pa aftë për punë;
- f) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- g) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.

(Shenim: Per te marre piket e plote te parashikuara per kete pyetje, mjafton qe kandidatet te kene permendur te pakten 4 nga subjektet e mesiperme.)

3. Përmendni dy rastet kur një tatimpagues jorezident mund të mos emërojë përfaqësues tatimor. (2 pikë)

Përgjigje:

Tatimpaguesi jorezident mund të mos emërojë një përfaqësues tatimor në një nga rastet e mëposhtme:

- a. Të gjitha të ardhurat, me burim në Shqipëri, janë objekt i tatimit përfundimtar, të mbajtur në burim (1 pikë);
- b. Tatimpaguesi e dorëzon vetë deklaratën tatimore (1 pikë).

4. A.B. është punonjës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve që në 4 nëntor 2014, me statusin e nënpunësit civil. Aktualisht është punësuar pranë një Universiteti privat në Tiranë, në lëndën e Taksimit, si dhe punon me kohë të pjesshme pranë një zyre kontabiliteti në Tiranë duke dhënë konsulencë fiskale për klientë të ndryshëm. Në përputhje me ligjin ‘Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë’, A.B. nuk ka kontrolluar asnjëherë apo vlerësuar tatimet e klientëve të zyrës së kontabilitetit. A mund të konsiderohet në këtë rast punësimi jashtë administratës tatimore si një situatë konflikti interesi? **(2 pikë)**

Përgjigje:

Në këtë rast punësimi i nënpunësit të administratës tatimore konsiderohet si më poshtë:

- a. Punësimi në zyrën e kontabilitetit, edhe pse me kohë të pjesshme, konsiderohet konflikt interesi, edhe pse në cilësinë e nënpunësit të administratës tatimore nuk ka kontrolluar apo vlerësuar tatimet e klientëve të tij **(1 pikë)**.
- b. Veprimtaria e mësimdhënies nuk konsiderohet konflikt interesi **(1 pikë)**.

5. Cilat janë procedurat e çregjistrimit të subjekteve që kryejnë aktivitet të tipit fermerë? **(2 pikë)**

Përgjigje:

Fermerët janë subjekte/ tatimpagues që regjistrohen vetëm në regjistrin e administratës tatimore/ në drejtoritë rajonale tatimore me **procedura të thjeshtuara. (1 pikë)**

Për rrjedhojë, çregjistrimi i këtyre subjekteve/tatimpaguesve bëhet **pranë drejtorive rajonale tatimore përkatëse**, sipas procedurave të thjeshtuara të parashikuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat. **(1 pikë)**

6. Gjatë muajit nëntor 2020, Shoqëria Ami Sh.p.k, tatimpagues i regjistruar për efekt të TVSH-së, për shkak të rinovimeve në ambjentet tregtare të filluara në datën 1 nëntor, nuk ka patur aktivitet dhe nuk ka regjistruar asnjë shitje për këtë periudhë. Në dhjetor 2020, Ami Sh.p.k rihap sërish ambjentet tregtare dhe rifillon shitjet. A duhet të bëjë Ami Sh.p.k deklaram për efekt të TVSH-së gjatë muajit dhjetor 2020? Cili është muaji i parë i deklarimeve pas rifillimit të aktivitetit tregtar? **(2 pikë)**

Përgjigje:

Po, gjatë muajit dhjetor 2020 Ami Sh.p.k duhet të bëjë deklaram për efekt të TVSH-së të cilat lidhen me muajin nëntor 2020. Muaji i parë për të cilin duhet të plotësohet dhe dorëzohet deklarata e TVSH-së është **nëntor 2020**, deri në datë 14 të muajit pasardhës, pra dhjetor 2020. **(1 pikë)**

Deklaratat tatimore e TVSH-së dorëzohet periodikisht, duke respektuar afatet ligjore, edhe nëse për periudha tatimore të caktuara, që në këtë rast është nëntor 2020, **nuk ka patur shitje gjatë kësaj periudhë tatimore. (1 pikë)**

7. Çfarë kuptoni me furnizim malli? Cilat janë transaksionet që cilësohen si të tilla? **(4 pikë)**

Përgjigje:

1. Me furnizim mallrash kuptohet transferimi i së drejtës për të disponuar si pronar pasurinë e trupëzuar. (2 pikë)
2. Konsiderohen gjithashtu si “Furnizim malli” edhe transaksionet e mëposhtme:
 - a) transferimi kundrejt pagesës i pronësisë së pasurisë, me urdhër nga/apo në emër të një autoriteti publik apo në zbatim të ligjit; (0.5 pikë)
 - b) dorëzimi i mallrave në bazë të një kontrate, ku parashikohet dhënia me qira e mallit për një periudhë të caktuar ose shitja me këste e mallit, kalimi i pronësisë i të cilit bëhet me pagesën e këstit të fundit; (0.5 pikë)
 - c) transferimi i mallrave bazuar në një kontratë, sipas së cilës paguhet komision për blerjen apo për shitjen. (0.5 pikë)
3. Furnizimi i energjisë elektrike, ujit, gazit, energjisë për ngrohje ose ftohje dhe të tjera të ngjashme trajtohet si furnizim malli i trupëzuar. (0.5 pikë)

8. Shpjegoni se si çfarë përcaktohet si dhuratë me vlerë të vogël dhe mostra (kampione). A janë këto furnizime kundrejt pagesës? **(4 pikë)**

Përgjigje:

a) Ligji përcakton se nuk konsiderohen si furnizim kundrejt pagesës rastet kur një person i tatueshëm përdor, shfrytëzon mallra të biznesit si dhurata me vlerë të vogël apo mostra (kampione). Si parim kur mallrat merren apo përdoren nga ndërmarrja konsiderohen si furnizim kundrejt pagesës të tatueshme me TVSH. Brenda kësaj kategorie përfshihen pikërisht mallrat që merren për qëllime private dhe nuk përdoren për realizimin e transaksioneve të tatueshme nga ndërmarrja ose kur këto mallra nuk përdoren për nevojat e shfrytëzimit të saj. Marrja e një “malli me vlerë të vogël” të transferuar pa pagesë nga mallrat e ndërmarrjes nuk është furnizim kundrejt pagesës në kuptim të ligjit dhe nuk kërkohet të zbatohet TVSH nëse plotësohen të dy kushtet e mëposhtme njëkohësisht:

1. Përdorimi kryhet për nevojat e veprimtarisë ekonomike.
2. Përdorimi lidhet me një mostër (kampion) ose me një objekt me vlerë të vogël (2pikë)

b) Për qëllime të aplikimit të dispozitës së parashikuar, mostër (kampion) konsiderohen ato objekte të lidhura drejtpërdrejtë me kryerjen e aktivitetëve të personave të tatueshëm, që i ofrohen konsumatorëve, klientëve të zakonshëm apo atyre potencial dhe nuk janë për qëllime shitje. Këto objekte nuk janë për qëllime shitje ose nuk shiten pasi kanë trajtën që pamundëson shitjen e tyre.

Mallrat që jepen si mostra biznesi duhet të jenë të shenjëzuara si të tilla dhe duhet ta kenë trajtën ose paketimin ndryshe krahasuar me mallrat (objektet) të cilat kanë për qëllim shitjen. (1 pikë)

c) Për qëllime të aplikimit të dispozitës së parashikuar, dhuratë me vlerë të vogël, konsiderohet një mall me vlerë individuale të tregut më të vogël se 2.000 lekë, që shpërndahet pa pagesë për qëllim të zgjerimit, publicitetit dhe promovimit të veprimtarisë ekonomike të personit të tatueshëm, të cilën personi i tatueshëm ia jep konsumatorëve të rregullt ose konsumatorëve potencial. Në rastin kur dhuratat janë nga mallrat e biznesit ky rregull lejohet të zbatohet vetëm për një objekt për të njëjtin përfitues dhe vetëm një herë në vit, pavarësisht vlerës së mallit, por jo më shumë se vlera e përcaktuar. Duhet të provohet qartësisht nga ana e personit të tatueshëm që një dhuratë me vlerë nën 2,000 lekë është përfituar vetëm për një objekt, njëherë të vetme nga i njëjti klient përgjatë një viti. (1 pikë)

9. Cilat janë veprimet që kryhen kur shuma e detyrimit tatimor të paguar nga tatimpaguesi është më e madhe sesa shuma e tatimit të vlerësuar në njoftimin për vlerësimin tatimor? (4 pikë)

Përgjigje:

Në raste të tilla, administrata tatimore e kalon shumën e paguar më tepër për llogari të detyrimeve të tjera tatimore, të papaguara nga tatimpaguesi.

Nëse mbetet ende tepër pas këtij veprimi, me miratimin me shkrim të tatimpaguesit, shuma e mbetur:

- a) rimburohet automatikisht, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e derdhjes së shumës së paguar më tepër; ose
- b) kalohet për llogari të detyrimeve tatimore të ardhshme të tatimpaguesit.

10. Çfarë informacioni duhet të përmbajë raporti përfundimtar i kontrollit tatimor? (4 pikë)

Përgjigje:

Raporti përfundimtar i kontrollit tatimor duhet të përshkruajë:

- a) vendin e kontrollit,
- b) periudhën për të cilën është kryer kontrolli,
- c) një listë të dokumenteve të shqyrtuara,
- d) personat e intervistuar,
- e) observacionin e tatimpaguesit të marrë në konsideratë dhe
- f) rezultatin përfundimtar të argumentuar të kontrollit.

11. Si trajtohen të ardhurat monetare të individit që shkojnë për shtim të kapitalit të shoqërisë të përftuara nga jashtë shoqërisë tregtare? (4 pikë)

Përgjigje:

Në të ardhura të tatueshme për qëllim të tatimit mbi të ardhurat personale, përfshihen të ardhurat e individëve, në formë monetare që shkojnë për shtimin e kapitalit të shoqërisë, të përftuara nga jashtë shoqërisë. Nëse këto të ardhura të individëve nuk janë tatuar më parë, ndërkohë që kanë qenë e janë objekt i tatimit dhe pagesës së tatimit mbi të ardhurat personale, për këto të ardhura

paguhet tatimi në masën 15%. Lidhur me origjinën e krijimit të të ardhurave në formë monetare, që shkojnë për rritjen e kapitalit të shoqërisë nga individit investues, duhet të paraqitet në organin tatimor një deklaram lidhur me origjinën e të ardhurave personale. Ky deklaram duhet të paraqitet sipas formularit “Deklarimi i individit kontribues në shtimin e kapitalit në formë monetare nga jashtë shoqërisë”, jo më vonë se data e derdhjes së të ardhurave për shtimin e kapitalit të shoqërisë në (QKB). Për individët e huaj ky deklaram duhet të paraqitet sipas formularit “Deklarimi i individit kontribues të huaj në shtimin e kapitalit në formë monetare nga jashtë shoqërisë”.

Në këtë deklaram duhet përshkruar burimi i këtyre të ardhurave. Bashkëngjitur me këtë deklaram, duhet të vendoset dokumentacioni plotësues zyrtar që vërteton shumën e këtyre të ardhurave dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat personale, përpara se këto të ardhura të investohen për shtimin e kapitalit të shoqërisë. Nëse ky dokumentacion mungon ose nuk vërteton, që për vlerën e plotë të të ardhurave të kontribuara është paguar tatimi mbi të ardhurat personale, mbi këtë vlerë të të ardhurave duhet të paguhet tatimi mbi të ardhurat në masën 15%. Ky tatim do të paguhet në të njëjtën datë që individit do të deklarojë të ardhurën monetare për shtimin e kapitalit të shoqërisë pranë QKB. PAGESA E TATIMIT MBI TË ARDHURËN PËR KONTRIBUTIN NË KAPITALIN E SHOQËRISË DUHET TË DERDHEJ nga individit kontribues, në llogarinë bankare të Drejtorisë Rajonale Tatimore, ku shoqëria është e regjistruar, me përshkrimin në dokumentin bankar të pagesës: -Derdhur tatim mbi të ardhurat për shtimin e kapitalit të shoqërisë.

12. Cilat janë kriteret që duhet të plotësojnë shpenzimet për të qënë të njohura për efekt të tatimit mbi fitimin dhe cilat janë dokumentet bazë për justifikimin e tyre? (4 pikë)

Përgjigje:

Shpenzime të njohura janë ato që kryhen për qëllime të biznesit, që synojnë sigurimin dhe ruajtjen e të ardhurave. Keto janë të gjitha shpenzimet (përfshirë shpenzimet e jashtezakonshme) e biznesit, me përjashtim të atyre që janë kryer me qëllim formimin dhe rritjen e kapitalit. Shpenzimet e njohura janë kryesisht shpenzime të destinuara për të ruajtur ekzistencën e kapitalit si burim i të ardhurave dhe për të siguruar në kohën e duhur riformimin apo zëvendësimin e kapitalit (p.sh amortizimi). Shpenzimet e njohura janë shpenzime që njihen si të zbritshme nga të ardhurat për përcaktimin e fitimit të tatueshëm. Për të qënë të njohura (të zbritshme) shpenzimet duhet të përmbushin këto kushte:

- a. të jenë kryer në interes të drejtëpërdrejtë të veprimtarisë ekonomike prej së cilës realizohen të ardhurat ose të jenë të lidhura me drejtimin normal të aktivitetit të tatimpaguesit;
- b. të jenë kryer ose të jenë përballuar efektivisht dhe të jenë të mbështetur në dokumente justifikuese të njohura ligjërisht;
- c. të jenë pasqyruar nëpërmjet një veprimi kontabël duke pakësuar aktivet neto;
- d. në çdo rast shpenzimet duhet të jenë të provuara nga tatimpaguesit me dokumentacionin përkatës ligjor.

Dokumente të përdorura si bazë për justifikimin e shpenzimit, për efekt tatimor, është fatura tatimore me TVSH, fatura e thjeshtë tatimore, faturat e leshuara nga persona jo-rezidentë që nuk janë të regjistruar në organet tatimore shqiptare dhe çdo dokument tjetër i lëshuar nga ente ose organizma juridike, Ambasada të huaja, organizma nderkombetare, zyra pune, komisariate policie, muzete e institucioneve publike etj., për pagesat e tarifave të shërbimeve që këto ente i kryejnë tatimpaguesve, subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Degët e tatimeve mund të kërkojnë interpretimin me shkrim

nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve lidhur me dokumenta të tjera të cilat nuk janë parashikuar në këtë udhëzim por që vërtetojnë shpenzime biznesore të subjektit.

13. Për cilët persona shpeshësia e deklaramit dhe pagesës së kontributeve për detyrimet shoqërore e shëndetësore është 3-mujore? (4 pikë)

Përgjigje:

- a. Personat fizikë dhe juridikë të regjistruar si tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël;
- b. Personat e vetëpunësuar në aktivitet tregtar apo shërbimi ambulant sipas kuptimit të VKM përkatës.
- c. Kryefamiljarët, që punësojnë persona si punëtorë shtëpie sipas kuptimit të VKM përkatës.

USHTRIME

Ushtrimi 1

“Home Design & Furniture” (HDF), ushtron aktivitetin e saj në fushën e importimit të mobiljeve të ndryshme për zyra dhe apartamente. Në janar të vitit 2020, ajo vendosi që të zgjerojë aktivitetin e saj edhe në prodhimin e mobiljeve. Për këtë qëllim, ajo bleu një ndërtesë në periferi të Tiranës për shumën 1 milion EUR të cilën do ta shndërronte si fabrikë për prodhimin e mobiljeve për qëllime zyrash. Gjithashtu, ajo ka nënshkruar edhe një kontratë me një furnitor të huaj për importimin e pajisjeve dhe makinerive me vlerë rreth 500,000 EUR për tu blerë brenda 6-mujorit të parë të vitit 2020.

Drejtuesi i HDF kërkon të dijë nga ju, nëse lejohet përjashtimi nga TVSH-ja për importimin e këtyre pajisjeve dhe nëse po, cilat janë dokumentat që ajo duhet të dorëzojë? (3 pikë)

Përgjigje:

Të gjithë personat e tatueshëm që kryejnë investime në makineri dhe pajisje në funksion të realizimit të kontratave të investimit me vlerë të barabartë ose më të madhe se **50 milionë** (pesëdhjetë milionë) lekë dhe që nuk janë për shitje, mund të kërkojnë përjashtimin nga TVSH-ja në import të këtyre pajisjeve. Në rastin e HDF, vlera e pajisjeve dhe makinerive për tu blerë është më e madhe se 50 milionë lekë dhe HDF ka të drejtën që të kërkojë përjashtimin nga TVSH-ja për importimin e këtyre pajisjeve dhe makinerive.

Personat e tatueshëm të cilët do të importojnë makineri dhe pajisje për qëllime përjashtimi duhet të paraqesin në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dokumentet, si më poshtë vijon:

- një kërkesë me shkrim, së cilës, kur kryhen veprime për herë të parë pranë autoriteteve doganore, i bashkëngjitet edhe një fotokopje e certifikatës së NUIS/NIPT-it;
- kopje të marrëveshjes me Këshillin e Ministrave, me anë të së cilës është miratuar kontrata e investimit, ku të jetë e specifikuar vlera e investimit e barabartë ose mbi 50 milionë (pesëdhjetë milionë) lekë (nëse ka një marrëveshje të tillë), ose, në raste të investimeve tërësisht private, kopje të lejes/licencës/autorizimit (vetëm për kërkesën e parë);

- kopje të planit të investimit, përfshirë preventivin, ku të jetë e përcaktuar se vlera e investimit është e barabartë ose mbi 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë, si dhe kohëzgjatja e investimit;
- kopje të planit të investimit, përfshirë preventivin, për vitin kur kryhen importet;
- të dhëna për llojin dhe sasinë e makinerive e të pajisjeve që do të importohen me kodet tarifore përkatëse dhe periudhën e instalimit;
- kopje të aktit të pronësisë apo të marrjes me qera të ambienteve ku do të bëhet investimi;
- përshkrimin skematik dhe narrativ të skemës teknologjike për çdo element të saj;
- Deklaratë e personit të tatueshëm që makineria apo pajisja, për të cilën kërkohet përjashtimi, nuk është importuar për qëllime shitjeje.

Ushtrimi 2

Kompania e ndërtimit “Arial Construction Sh.p.k.” është në përfundim tërësor të një objekti në ndërtim (pallat) në qytetin e Tiranës ku ajo ka qenë njëkohësisht ndërtuesi dhe investitori. Aktualisht kompania është në fazën e kalimit të pronësisë drejt klientëve të saj. Më konkretisht, në bazë të kontratave të mëparshme të pronësisë, ajo i ka transferuar një klienti një apartament me një sipërfaqe 90 m² si dhe një njësi parkimi me sipërfaqe 20 m²?

Përcaktoni se kush duhet të paguajë taksën e kalimit të pronësisë në këtë rast për apartamentin dhe njësinë e parkimit dhe si llogaritet kjo taksë? (2 pikë)

Përgjigje:

Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Në rastin e Investitorëve në biznesin e ndërtimit të cilët janë regjistruar në organet tatimore si persona juridike (shoqëri tregtare) me objekt ndërtimin dhe shitjen e pasurive të paluajtshme, janë subjekt pagues i “taksës” vendore mbi kalimin e të drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, sipas parashikimeve të nenit 28 të ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Në rastin tonë, në bazë të ligjit, taksa e kalimit të pronësisë duhet të paguhet nga “Arial Construction Sh.p.k.” (me përjashtim të rastit kur palët mund të kenë rënë dakort ndryshe midis tyre).

Baza e taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet.

- Taksa për kalimin e pronësisë për apartamentin = 90 m² x nivelin e taksës për m² për ndërtesa banimi (prsh. për Tiranën = 1,000 leke/m²)
- Taksa për kalimin e pronësisë për njësinë e parkimit = 20 m² x nivelin e taksës për m² për ndërtesa të tjera (prsh. për Tiranën = 1,500 leke/m²)

Ushtrimi 3

1. Shoqëria Teorema Sh.p.k, call-center në Tiranë, ka deklaruar dhe paguar TVSH në vlerën 1,982,000 Lekë për periudhën qershor 2019. Gjatë një auditimi financiar të kryer në vitin 2020 lidhur me pasqyrat financiare për vitin 2019, u identifikua një faturë karburanti për të cilën gabimisht ishte aplikuar e drejta e zbritjes së TVSH-së në vlerën 10,000 Lekë. Për vitin 2019

shoqëria Teorema Sh.p.k është kontrolluar nga ana e Administratës Tatimore vetëm për tatimin mbi fitimin. **(5 pikë)**

- a. A plotësohen kushtet për të ndryshuar deklaratën e TVSH-së për periudhën qershor 2019? Argumentoni pergjigjen tuaj. **(2 pikë)**
- b. Me çfarë detyrimesh shtesë do të përballlet shoqëria në momentin që dorëzon një deklaratë tatimore të korrigjuar? **(3 pikë)**

Përgjigje:

- a. Po, deklarata e ndryshuar për periudhën qershor 2019 mund të dorëzohet prej tatimpaguesit brenda 36 muajve që nga afati i dorëzimit të deklaratës fillestare **(1 pikë)**; pra plotësohet kushti i afatit kohor dhe kushti i dytë që deklarata e TVSH-së nuk është kontrolluar më parë nga Administrata Tatimore **(1 pikë)**.
- b. Dorëzimi i një deklarate tatimore të ndryshuar për rastin konkret përfshin dhe sjell këto detyrime shtesë monetare për Teorma Sh.p.k.:
 - i. Pagesën e detyrimit tatimor shtesë që vjen si rezultat i korrigjimit të TVSH-së për vlerën 10,000 Lekë **(1 pikë)**;
 - ii. Gjorbë në masë 0.06% në ditë për shumën e detyrimit të papaguar në kohë, ndërmjet afatit të dorëzimit të deklaratës për periudhën dhe dates së pagesës. Në asnjë rast, gjorba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike **(1 pikë)**;
 - iii. Kamatvonesën për periudhën ndërmjet afatit të dorëzimit të deklaratës fillestare dhe datës së pagesës së detyrimit sipas deklaratës tatimore të ndryshuar **(1 pikë)**.

Ushtrimi 4

Shoqëria “A” subjekt i tatueshëm ka bërë eksport malli në Itali te një subjekt i tatueshëm X. Transportin e ka kryer me një shoqëri transporti mallrash me seli në Shqipëri. Po kështu ka kryer eksport malli në Itali edhe shoqëria “B”, për llogari të një individi shqiptar resident në Itali.

Gjatë kontrollit tatimor, në shoqërinë “A” u verifikua se ekzistonte vetëm fatura e eksportit dhe një kopje e CMR-së së firmosur dhe vulosur nga pritësi i mallit në Itali, por nuk kishte deklarate doganore. Ndërsa në kontrollin tatimor të ushtruar te subjekti “B” u verifikua se kishte faturë dhe deklarate doganore ku vërtetohej se malli kishte dalë nga Shqipëria por nuk kishte CMR të firmosur nga individi rezident në Itali.

Pyetja shtrohet: Me qenë se për rastet e eksporteve TVSH është zero për qind, çfarë dokumentacioni siguruan subjektet “A” dhe “B” për të mos u bërë subjekt i penalizimit me gjorbë.

Cili nga subjektet megjithëse i plotësoi dokumentat u dënua me gjorbë? (5 pikë)

Përgjigje:

Shoqëria “A” me qenë se kishte faturën dhe CMR-në në rregull kishte mundësi të merrte pranë organit Doganor një fotokopje të deklaratës doganore, për pasojë eksporti u quajt i rregullt. Në rastin kur kemi të bëjmë me një person të tatueshëm të vendosur jashtë Shqipërisë, të furnizuar nga një person i tatueshëm në Shqipëri, subjekti i huaj nuk është i tatueshëm në Shqipëri. **(2 pikë)**

Ndërsa shoqëria “B” pavarsisht se kishte deklaraten doganore të eksportit orgjinale, dhe mori firmën në CMR nga individit pritës rezident në Itali, u penalizua. Arsyeja e penalizimit ka të bëjë me faktin se individit pritës i mallit në Itali nuk ishte subjekt i tatueshëm për TVSH-në në Itali. Në rastin kur kemi të bëjmë me një person të patatueshëm të vendosur jashtë Shqipërisë, të furnizuar nga një person i tatueshëm në Shqipëri, subjekti i huaj është i tatueshëm në Shqipëri **(3 pikë)**

Ushtrimi 5

Subjekti “A” në Qershor të Vitit 2017 ka kryer import mallrash dhe duke qenë person i tatueshëm ka paguar TVSH-në në shumën 1,600,000 lekë. Po kështu Subjekti “B” në Prill të Vitit 2018 ka kryer import mallrash duke paguar TVSH-në në shumën 1,200,000 lekë.

Në Shtator të vitit 2018 Organet e Kontrollit të Brendshëm Doganor gjatë auditit kanë gjetur shkele në praktikat doganore, ku subjektit “A” i kanë rivlerësuar detyrimin për TVSH-në në ulje për shumën 300,000 lekë, ndërsa subjektit B i kanë rritur detyrimin për TVSH-në në shumën 150,000 lekë.

Si duhet të procedojnë Subjektet “A” dhe “B” për të reflektuar ndryshimet në detyrimin doganor? (5 pikë)

Përgjigje:

Pas kryerjes së procedurave të importit, autoriteti doganor mund të kryejë rivlerësime të vlerës doganore të mallrave të importuara. Dallohen rastet :

a) Rivlerësim në rritje i vlerës doganore të importit: personi i tatueshëm është debitor ndaj doganës. Vetëm pasi ai shlyen detyrimin ndaj doganës i njihet vlera e rritur e TVSH-së së zbritshme nga importi në Deklaratën e TVSH-së të muajit në të cilin është bërë pagesa. Në rast se nuk është paguar TVSH, personi i tatueshëm nuk ka të drejtë të zbresë TVSH-në.

Nëse pagesa për detyrimin e TVSH-së të vlerësuar nga autoriteti doganor në import është kryer përtej 12 periudhave tatimore nga momenti kur personit të tatueshëm i është kryer rivlerësimi duke u deklaruar debitor nga autoriteti doganor, atëherë TVSH e paguar më vonë se 12 periudha tatimore nuk njihet si e zbritshme. (2 pikë)

b) Import rivlerësim në ulje i vlerës doganore: personi i tatueshëm ka paguar TVSH në import më shumë nga sa i takonte dhe nga ana tjetër në autoritetin tatimor ka deklaruar TVSH të zbritshme, aq sa TVSH-ja e paguar në import.

Në rast se autoriteti doganor i bën një rivlerësim në ulje të vlerës doganore edhe TVSH-së përkatëse, njofton në të njëjtën kohë edhe autoritetin tatimor. Personi i tatueshëm detyrohet të ndryshojë deklarimin e TVSH-së në përputhje me vlerat e saktësuara nga ana e autoritetit tatimor, për të reflektuar një situatë reale dhe në përputhje me deklaratat doganore. Nëse personi i tatueshëm nuk e bën me vullnetin e tij këtë saktësim, autoriteti tatimor kryen veprimet për saktësimin e TVSH-së së zbritshme. (2 pikë)

c) Subjekti “A” është jashtë afatit 12 mujor dhe për pasojë do të korrigjojë në ulje detyrimin doganor për TVSH-në duke e kaluar atë në kosto.

Ndërsa subjekti “B” është brenda afatit 12 mujor dhe do korrigjojë në rritje detyrimin doganor për TVSH-në duke kryer edhe pagesën përkatëse. (1 pikë)

Ushtrimi 6

Agjencia ofron një udhëtim turistik nëpër jugun e Shqipërisë i cili zgjat 2 netë dhe çmimi i përcaktuar për çdo udhëtar është 15.000 lekë.

Në tabelën e mëposhtme janë faturat e pranuar nga agjencia turistike për këtë udhëtim:

Fatura	Vlera pa tvsh	Tvsh	Vlere me tvsh
Shërbim fjetje hoteli 2 net/person	4000	240	4240
Shërbim transporti vajtje ardhje/person	1000	200	1200
Shërbim katering /person	2000	400	2400

Cfarë faturash duhet të lëshojë agjencia ndaj klientit dhe deklarimet që duhet të bëjë në Librin e Shitjes? Si duhet të rregjistrojë Faturat e blerjeve në tabelën e mësipërme? (5 pikë)

Përgjigje:

* Cmimi I paguar nga udhetari 15.000 leke

(-) totali I shpenzimeve/ per person 7840 leke {4240+1200+2400}

=Marzhi I Agjensise 7160 leke

TVSH e mbledhshme = $7160 \cdot 20 / 120 = 1193$ lekë (2pikë)

* Në faturën e shitjes që agjencia i bën klientit shënon vetëm vlerën totale të paguar prej 15.000 lekë pa llogaritur dhe pa shfaqur TVSH në faturë. Fatura e shitjes duhet të ketë shënimin “TVSH- ja është zbatuar mbi marzhin, regjimi i agjencive të udhëtimit”, dhe deklarohet në librin e shitjes dhe nëdeklaratën e muajit në të cilën lëshohet, e detajuar si më poshtë:

Vlera 7840 lekë në kutinë “Shitje pa TVSH”

Vlera e tatueshme 5967 lekë si dhe 1193 lekë TVSH në kutitë përkatëse “Shitje Regjimi agjentëve të udhëtimit”. (2pikë)

* Faturat e blerjes për shërbimin e fjetjes në hotel, transport, shërbim catering deklarohen në kutinë “Blerje me TVSH jotë zbritshme/pa TVSH” të librit të blerjes dhe deklaratën përkatëse të muajit kur ato furnizohen nga të tretët. (1 pikë)

Ushtrimi 7

Kryefamiljari ka të ardhura vjetor në vlerën 2,500,000 Lekë. Këto të ardhura përbëhen si më poshtë:

- Të ardhura nga punësimi 1,900,000 Lekë
- Të ardhura nga shpronësimi 400,000 Lekë
- Të ardhura nga kalimi i të drejtës së pronës mbi tokën bujqësore 200,000 Lekë

Bashkëshortja e tij ka të ardhura vjetor në vlerën 1,000,000 Leë.

Shpenzimet vjetore për mjekimin e fëmijëve janë: 10,000 Lekë

Përcaktoni detyrimet dhe të drejtat që ka secila palë në lidhje me plotësimin e deklaratës individuale vjetore të të ardhurave. (5 pikë)

Përgjigje:

Detyrimi për dorëzimin e deklaratës individuale vjetore të të ardhurave e kanë të gjithë individët rezidentë në Republikën e Shqipërisë për të ardhurat vjetore totale bruto të realizuara brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Detyrimin për deklarim e kanë edhe individët jorezidentë vetëm për të ardhurat e tatueshme të realizuara prej tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë kur këto të ardhura bruto janë në shumën 2,000,000 lekë dhe mbi këtë shumë. Deklarata individuale vjetore e të ardhurave dorëzohet në drejtorinë rajonale tatimore më të afërt me vendbanimin e individit

Dorëzimi i deklaratës individuale vjetore bëhet jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore për të cilën bëhet deklarimi.

Deklarata e të ardhurave individuale vjetore mund të plotësohet edhe nga individët të cilët nuk kanë detyrimin ligjor për të plotësuar dhe dorëzuar deklaratën, nëse këta individë duan të përfitojnë nga skema e shpenzimeve të zbritshme e parashikuar në ligj, kur plotësojnë kushtet e përfitimit të zbritjes së shpenzimeve. Mund të bëjnë deklarim edhe individët tatimpagues, të cilët nuk janë subjekt i deklarimi, por duan të plotësojnë deklaratën dhe kanë të ardhura bruto vjetore nga të gjitha burimet deri në shumën 1,050,000 (një milion e pesëdhjetë mijë) lekë në vit (e indeksueshme çdo vit), por jo më të lartë se kjo shumë.

Në rast të plotësimit të gabuar të deklaratës, individi mund të korrigjojë deklaratën, duke plotësuar një deklaratë të re, duke vendosur shenjën “X” në kutinë përkatëse (deklaratë korrigjuese), brenda tre muajve nga data e dorëzimit të deklaratës së parë. Individi tatimpagues deklarues ka të drejtën e korrigjimit për saktësim të deklaratës së dorëzuar prej tij deri në dy herë pa u penalizuar, brenda tre muajve nga dorëzimi i deklaratës. Në rast të një korrigjimi tjetër të tij, pas atij të dytë, brenda afatit tremujor nga dorëzimi i deklaratës fillestare ndaj individit tatimpagues deklarues zbatohen sanksionet e përcaktuara të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar “Plotësimi i pasaktë i deklaratës tatimore dhe kërkesa e pasaktë për rimbursim”.

Pagat dhe shpërblimet e tjera në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës (të ardhurat nga punësimi) janë të ardhura të tatueshme. Në këtë kategori të ardhurash përfshihen si pagat, ashtu edhe shpërblime të tjera në vlerë që lidhen me punësimin aktual të individit.

Të ardhurat e përfituara, përfshirë të ardhurat në formë monetare apo në natyrë, nga pronarët si shpërblim për shpronësimet që i bëhen nga shteti për interesa publike. Në çdo rast përjashtimi duhet të bazohet në dokumentacionin ligjor që vërteton natyrën e këtyre të ardhurave;

Të ardhurat e përfituara nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi tokën bujqësore nga një fermer i regjistruar te një fermer apo person fizik a juridik që kryen aktivitet bujqësor, janë të ardhura të përjashtuara nga tatimi mbi të ardhurat personale”. Duke qënë që kryefamiljari nuk përcaktohet si fermer apo person fizik apo juridik që kryen aktivitet bujqësor, të ardhurat e fituara nga kalimi i së drejtës së tokës bujqësore nuk janë të ardhura të përjashtuara.

Të ardhurat e tatueshme të kryefamiljarit:

- Të ardhura nga punësimi 1,900,000 Lekë
- Të ardhura nga kalimi i të drejtës së pronës mbi tokën bujqësore 200,000 Lekë

TOTALI 2,100,000 Lekë

Duke qënë se të ardhurat bruto të kryefamiljarit janë mbi shumën 2,000,000 Lekë, atëherë Kryefamiljari duhet të plotësojë deklaratën individuale vjetore duke iu përmbajtur procedurave më sipër.

Të ardhurat e tatueshme të bashkëshortes: 1,000,000 Lekë

Të ardhurat e bashkëshortes janë nën 1,050,000 (një milion e pesëdhjetë mijë) lekë në vit (e indeksueshme çdo vit). Në rast se të ardhurat vjetore bruto të kryefamiljarit tejkalojnë shumën prej 2,000,000 lekësh dhe në bazë të ligjit kryefamiljari ka detyrim për plotësimin e deklaratës vjetore të të ardhurave personale, por jo të përfitojë nga shpenzimet e zbritshme dhe bashkëshortja e tij ka totalin e të ardhurave vjetore bruto më të vogla se 1,050,000 lekë, atëherë kjo e fundit nuk mund të përfitojë nga e drejta e plotësimit të deklaratës për efekt të shpenzimeve të zbritshme

Ushtrimi 8

Shoqëria A ka rezultatet si më poshtë:

Viti	Fitim / (humbje tatimore)	Fitim/ (humbje jo tatimore)	Ndryshimi i pronësisë
20X1	(7,000,000)	(10,000,000)	-
20X2	5,000,000	7,000,000	10%
20X3	1,000,000	1,500,000	-
20X4	(3,000,000)	(3,000,000)	55%
20X5	2,000,000	2,000,000	-

Norma e tatim te fitimi është 15%.

Llogarisni detyrimet për tatimin mbi fitimin për secilin vit ushtrimor. Llogarisni kestet e tatim fitimit qe duhet te parapaguaje shoqeria per vitin 20X6. Argumentoni përgjigjen tuaj. (5 pikë)

Përgjigje:

Viti	Fitim / (humbje tatimore)	Humbja e viti që paraardhës mbartet	Fitimi i tatueshëm	Tatim fitimi
20X1	(7,000,000)	-	-	-
20X2	5,000,000	(5,000,000)	-	-
20X3	1,000,000	(1,000,000)	-	-
20X4	(3,000,000)	-	-	-
20X5	2,000,000	-	2,000,000	300,000

Humbja e rezultuar dhe e njohur nga organet tatimore, mund të mbartet në tre vitet e ardhshme radhazi. Kështu, humbjen e rezultuar në vitin 20X1 me 7 milionë lekë humbje, tatimpaguesi ka të drejtë ta mbartë këtë humbje në tre vite radhazi deri në vitin 20X4.

Kështu fitimi prej 5 milionë lekë në vitin 20X2, për efekt fiskal, i lejohet të përdorë të gjithë fitimin e këtij viti për të mbuluar humbjen e vitit parardhës. Pra, nga 7 milionë humbja reduktohet në 2 milionë lekë. Në vitin 20X3 subjekti rezulton përsëri me fitim 1 milionë lekë, ai mund ta përdorë këtë fitim për të mbuluar humbjen e mbetur prej 2 milionë nga humbja e vitit 20X1, e cila tashmë reduktohet në $7-5-1 = 1$ milionë lekë.

Në vitin 20X4 subjekti rezulton me humbje dhe ndryshimi i pronësisë është më shumë se 50%. Në këtë mënyrë, e drejta e mbartjes së humbjes së mbetur nga viti 20X1 humbet. Kështu, çdo humbje mund të mbartet deri në tre vitet e ardhshme, duke u evidentuar veçmas humbja e çdo viti, me parimin sipas të cilit humbja me e hershme mbartet përpara humbjes më të vonë. Nëse një humbje nuk arrin të mbartet për tre vite pasardhëse radhazi (pasi subjekti mund të rezultojë përsëri me humbje), ajo nuk mund të shtrihet më tej dhe të prekë rezultatin e viteve të tjera, para aplikimit të tatimit mbi fitimin.

Ndalohet transferimi i humbjes së shoqërive, pasi i mbartja e humbjes duhet të jetë e lidhur vetëm me tatimpaguesin që e pëson atë. Meqënëse zbatimi i këtij parimi kërkon që referimi të bëhet ndaj pronarit të shoqërisë, në rast se gjatë një periudhe tatimore pronësia e drejtpërdrejtë dhe/ose e terthortë e kapitalit themeltar, ose të drejtave të votës të një personi ndryshon me më shumë se 50%, në vlerë ose në të drejta votash, e drejta e mbartjes së humbjes në atë periudhë tatimore dhe në periudhat paraardhëse të tatimit humbet,

Kështu, humbja e vitit 20X4 nuk mund të mbartet pasi gjatë vitit pronësia e drejtpërdrejtë e kapitalit ndryshon me më shumë se 50%. Fitimi i tatueshëm i vitit 20X5 është fitimi tatimor i tatueshëm, pa u zbritur asnjë humbje e mbartur sipas arsytimit më lartë.

Ushtrimi 9

- a) Paraqisni në një tabelë shkallët e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi për nivelet e të ardhurave të përcaktuar në ligjin. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (2 pikë)
- b) Për listë pagesën e mëposhtme, llogarisni tatimin e të ardhurave nga punësimi: (2 pikë)
- c) Në rast dypunësimi a ka një limit të sipërm në lidhje me bazën e tatueshme për efekt të tatimit të të ardhurave dhe në qoftë se po sa është ky limit – (1 pikë)

Llogarisni tatimin për tu paguar nga Individidi S.A për të ardhurat e mëposhtme të realizuara gjatë vitit 2019.

	PERSHKRIMI	
1	të ardhura nga pagat si i punësuar në shoqëri tregtare	1,320,000
2	të ardhura nga dividendi	260,000

3	të ardhura nga dëmshpërblime për shpronësim të një sipërfaqe toke që dispononte ku do të ndërtohet një vepër publike	5,875,400
4	të ardhura nga qiraja	320,000
5	të ardhurat e përfituara si rezultat i kompensimit financiar për ish-pronarët	1,342,000
6	paguar nga shtëpi botuese për të drejtat e autorit	450,000
7	shpërblim për rezultate sportive nga federata e "qitjes"	70,000
	TOTALI	9,637,400

Përgjigje:

- **Të ardhura nga pagat si i punësuar në shoqëri tregtare** , janë të ardhura të tatueshme sipas shkallës tatimore të përcaktuar në ligj dhe konkretisht:
 - Nga 0 deri në 30.000 lekë : 0%
 - Nga 30.001 deri 150.000 lekë : 13 %
 - Mbi 150.001 : 23%
- **të ardhura nga dividendi**: janë të ardhura të tatueshme në normën 8% .
- **të ardhura nga dëmshpërblime për shpronësim** të një sipërfaqe toke që dispononte ku do të ndërtohet një vepër publike : janë të ardhura të përjashtuara nga tatimi i të ardhurave (0%)
- **të ardhura nga qiraja** : janë të ardhura të tatueshme në normën 15%
- **të ardhurat e përfituara si rezultat i kompensimit financiar për ish-pronarët** : janë të ardhura të përjashtuara nga tatimi i të ardhurave (0%)
- **paguar nga shtëpi botuese për të drejtat e autorit** : janë të ardhura të tatueshme në normën 15%
- **shpërblim për rezultate sportive nga federata e "qitjes"**: janë të ardhura të përjashtuara nga tatimi i të ardhurave (0%)

Llogaritje:

			norma	tatimi
	PERSHKRIMI			
1	të ardhura nga pagat si i punësuar në shoqëri tregtare	1,320,000	13%	124,800
2	të ardhura nga dividendi	260,000	8%	20,800
3	të ardhura nga dëmshpërblime për shpronësim të një sipërfaqe toke që dispononte ku do të ndërtohet një vepër publike	5,875,400	0%	-
4	të ardhura nga qiraja	320,000	15%	48,000
5	të ardhurat e përfituara si rezultat i kompensimit financiar për ish-pronarët	1,342,000	0%	-

6	paguar nga shtëpi botuese për të drejtat e autorit	450,000	15%	67,500
7	shpërblim për rezultate sportive nga federata e "qitjes"	70,000	0%	-
	TOTALI	9,637,400		261,100

Të ardhurat për vitin 2019 nga pagat si i punësuar në shoqëri tregtare janë 1.320.000 lekë. Paga mujore 110.000 lekë (1.320.000/12). **Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi për muajin (110.000-30.000) x 13% =10.400 lekë. Për vitin 2019: 10.400 x 12=124.800 lekë.**

Në rast dypunësimi a ka një limit të sipërm në lidhje me bazën e tatueshme për efekt të tatimit të të ardhurave dhe në qoftë se po sa është ky limit? (1 pikë)

Jo, nuk ka një limit të tillë për tatimin mbi të ardhurat nga punësimi.

Ushtrimi 10

Një funksionar i lartë i administratës publike, plotësoi me vonesë deklaratën individuale vjetore të të ardhurave (DIVA) për vitet 2018 dhe 2019. Gjithsesi nga plotësimi i deklaratës jashtë afatit nuk rezultuan detyrime shtesë tatimore. Sa është masa e gjobës që ky zyrtar duhet të derdhë pranë organeve tatimore. **(5 pikë)**

Përgjigje:

Në këtë rast, sanksioni përbëhet vetëm nga gjoba prej 5.000 x 2 vite = 10.000 lekë, pa penalitete shtesë.

Ushtrimi 11

Një person është i vetëpunësuar me pagë minimale dhe ndërkohë fillon punë në një kompani me pagë 75.000 lekë bruto në muajin Nëntor 2020. Sa do të jetë detyrimi për sigurimin shoqëror e shëndetësor që ky person duhet të paguajë për muajin Nëntor? **(5 pikë)**

Përgjigje:

Sigurimi shoqëror

Kompania

75.000 lekë x 9,5% = 7.125 lekë (personi)

75.000 lekë x 15% = 11.250 lekë (kompania)

Vetëpunësimi

26.000 lekë x 23% = 5.980 lekë (personi)

Total personi = 7.125 + 5.980 = 13.105 lekë

Sigurimi shëndetësor

Kompania

$75.000 \times 1,7\% = 1.275$ lekë (kompania)

$75.000 \times 1,7\% = 1.275$ lekë (personi)

Vetëpunësimi

$2 \times 260.000 \times 3,4\% = 1.768$ lekë (personi)

Total personi = $1.275 + 1.768 = 3.043$ lekë